



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

KODI I ETIKËS PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Pejë, Janar 2023

KODI I ETIKËS PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA” NË PEJË

Jeta studentore në UHZ duhet të jetë një përvojë aktive, harmonike, etike dhe pozitive e përqendruar në mësim, kërkim shkencor dhe rritje profesionale dhe personale.

UHZ pret që studentët e tij të respektojnë vlerat e institucionit të përshkruara më poshtë. Vlerat janë themelore për të udhëhequr çdo ndërveprim për dhe ndaj anëtarëve të UHZ-së. Studentët, pritet të marrin parasysh vlerat e UHZ-së për:

- **Integritet profesional dhe akademik** - Të hapur dhe të sinqertë në veprimet tona;
- **Gjithëpërfshirje dhe barazi** - Vlerësojmë diversitetin, përfshirjen, kujdesin, respektin dhe mirëpresim gjithsecilin;
- **Lirinë e shprehjes dhe të menduarit** – Inkurajojmë dhe vlerësojmë lirinë e shprehjes dhe mendimin kritik akademik;
- **Konkurrueshmërinë** - Dëshira dhe motivimi për t'u bërë më të suksesshëm dhe më të dallueshëm;
- **Shërbimin ndaj komunitetit** - Bashkëpunim me grupe të interesit për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tyre.

Studimi në UHZ paraqet mundësi për ndërveprim me anëtarët e tjerë të komunitetit të UHZ-së. UHZ njeh dhe vlerëson diversitetin e përvojave dhe pritshmërive të studentëve dhe është i përkushtuar që t'i trajtojë studentët, si akademikisht ashtu edhe personalisht, në mënyrë të drejtë dhe transparente. Të gjithë studentët në këmbim, duhet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në këtë Kod.

PARIMET E PERGJITHSHME

1. Duke u bazuar në lirinë akademike të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për veprimtari studimore, hulumtuese dhe artistike, dhe në autonominë që gëzon universiteti, Këshilli Drejtues pas propozimit të Senatit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë miraton Kodin e Etikës për studentët.
2. Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë nëpërmjet këtij dokument përcakton dhe garanton detyrimet dhe përgjegjësitë etike dhe sjelljen e përgjegjshme të studentëve për ndjekjen e qëllimeve akademike, shkencore dhe kërkimore, për nxitjen e meritës dhe përsosmërisë, për krijimin e një mjedisi profesional që është i bazuar mbi standarde të rrepta shkencore dhe profesionale, respekt për të drejtat e të tjerëve, sjellje etike dhe ndërgjegjësimi për ndikimin që shkenca ka mbi njeriun dhe mjedisin që e rrethon, marrëdhënieve ndërpersonale dhe mbrojtjes së vlerave individuale.
3. Ky dokument u kërkon studentëve, të përmbushin dhe të promovojnë parimet themelore dhe vlerat e etikës siç janë: Integriteti, Ndershmëria, Vërtetësia, Transparenca, Respekti

për të tjerët, Llogaridhënia, Drejtësia, Barazia, Drejtësia Sociale, Mirëbesimi, Objektiviteti, Singëriteti dhe Liria Akademike.

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Kod ka për qëllim ndërtimin e një mjedisi funksional akademik të punës, nxitjen e sjelljes së virtytshme si dhe parandalimin dhe trajtimin e rasteve të sjelljeve joetike ose të paligjshme brenda universitetit nga studentët.
2. Synon të ruajë vlerat themelore të komunitetit akademik, të ndërgjegjësojë studentët dhe të ndërtojë kulturë institucionale dhe akademike të bazuar në standardet etike, ligjore, të sigurojnë ambient bashkëpunues akademik, ndërmjet personelit studentëve më personelin akademik dhe administrativ, dhe me secilin person ose grup tjetër që kanë marrëdhënie kontraktuale ose interes që ka të bëjë me punën e universitetit.
3. Siguron njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive individuale akademike si dhe siguron respektimin e detyrave dhe përgjegjësiwe etike të studentëve në raport më personelin akademik, administrativ dhe ndaj institucionit. Përcakton rregullat e sjelljes së studentëve që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë gëzojnë marrëdhënie me Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.
4. Kodi Etik për studentë nxit vlerat e UHZ-së dhe inkurajon angazhim aktiv ndërmjet UHZ-së dhe studentëve brenda konteksteve të praktikës profesionale, të mësuarit dhe mësimdhënies dhe jetës brenda institucionit.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Kodi i Etikës është i detyrueshëm për të gjithë studentët e UHZ - së, pavarësisht nga forma dhe lloji i statusit të tyre, që janë pjesë e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.
2. Kodi i Etikës shtrin efektet e tij në gjithë veprimtarinë dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.
3. Personeli akademik dhe administrativ ka Kod veçantë të Etikës andaj nuk përfshihet në këtë Kod.

Neni 3

Detyruar dhe Përgjegjësit e Studentëve

Studentët kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e këtij Kodi për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit. Studentët në hapësirën universitare, janë të detyruar:

1. Të zbatojnë orarin e mësimi dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
2. Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambientet e institucionit, që nënkupton një veshje të përshtatshme, jo ekstravagante dhe duke mos ekspozuar trupin, universiteti nuk ndalon tatuazhet, pirsingun (shpimi), pikturimin me këna mirëpo universiteti nuk lejon veshjen e rrobave ose shfaqjen e tatuazheve, shenjave, simboleve, etj, të cilat tregojnë mesazhe të turpshme ose parulla sektare ose diskriminuese.
3. Të përdorin një fjalor të përshtatshëm, me intonacione të rregullta sipas normave të etikës, moralit dhe të mirësjelljes;
4. Të respektojnë personelin akademik dhe administrativ, kolegët dhe rregullat e mësimi.
5. Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese ose ngacmuese ndaj personelit akademik, stafit administrativ ose studentëve të tjerë, në mjediset e institucionit;
6. Të mos ofrojnë në asnjë formë, privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa ose dhurime, vetë ose nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, ose favorizime të tjera, të cilat stafi akademik ose anëtarë të tjerë të personelit të universitetit mund t'i kryejnë për shkak të detyrës;
7. Të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore;
8. Të mos shpërndajnë dhe konsumojnë pije alkoolike, substanca narkotike dhe duhan në ambientet e institucionit;
9. Të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimi ose provimit në salla;
10. Të mbajnë me vete përgjatë procesit mësimor kartelën e studentit të dhënë nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.
11. Kur merr pjesë në aktivitete studimore ose kërkimore, nuk duhet të përfshihet në plagjiaturë siç përcaktohet në Rregulloren e institucionit, të mos përmendë ose atribuojë punën e të tjerëve, të kalojë punën e të tjerëve si punën e tyre, ose të falsifikojë rezultatet, dhe duhet të respektojë parimet etike në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe parimeve të tjera specifike në fushat e përcaktuara lëndore sipas rregullave të institucionit.
12. Ndërhyrje ose përçarje që pengon, dëmton misionin e universitetit, proceset ose funksionet që shkelin të drejtat e të tjerëve. Veprat penale përfshirë këtu janë: pushtimi i çfarëdo ndërtese të universitetit; ose pasurisë ose pjesë të tyre, pa autorizimin e universitetit, bllokimi i hyrjes ose daljes së ndonjë ndërtese të universitetit; vendosjen e zjarrit ose me ndonjë mjet tjetër, duke dëmtuar ndërtesë, pronën ose pasurinë universitare;
13. Nuk u lejohe zbatimi i programeve ose ndërmarrja e aktiviteteve/veprimeve që përbëjnë shkelje të së drejtës vendore ose shtetërore dhe politikave të universitetit. Studentët nuk ju lejohe të flasin në emër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, me mediat.
14. Studentët nuk u lejohe të ftojnë në ambientet ose eventet e universitetit organizata të mediave, përjashtuar rastet kur merret leje me shkrim nga autoritetet drejtuese. Studentët si individë ose përfaqësues të organizatave studentore nuk u lejohe të hyjnë në marrëveshje

verbale, ose me shkrim që kanë për qëllim të lidhin, detyrojnë, ose krijojnë ndonjë lloj përgjegjësie për Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Universiteti do t’i konsiderojë të gjithë këta studentë përgjegjës për pasojat financiare, juridike ose dëmet që mund të rezultojnë nga veprime të tilla të paautorizuara;

15. Të mos falsifikojë ose manipulojë shkresa dhe dokumente zyrtare të universitetit, të përdorin dokumentet dhe të dhënat zyrtare të universitetit për qëllime të tjera që mund të keqinterpretohen. Përdorimi i rrjetit elektronik të të dhënave ose ndonjë pajisje elektronike në pronësi dhe administrim të universitetit për qëllime të paligjshme/të pahijshme, në shkelje të rregullores, politikave të universitetit ose ligjeve është e ndaluar;
16. Të mos bëjë përvetësime të paautorizuara të aseteve ose shërbimeve brenda universitetit.
17. Nuk lejohet zotërimi, përdorimi, ruajtja, ose transportimi i armëve të zjarrit, armëve të ftohta, eksplozivit fishekzjarrëve, ose kimikateve të rrezikshme që përbëjnë rrezik për mirëqenien e anëtarëve të komunitetit universitar.
18. Të mos ofrojë apo publikojë dëshmi dhe informacione të rreme për kolegë dhe personelin e UHZ-së apo të fshehë dëshmi përballë Organeve Kolegjiale ose anëtarëve të personelit të universitetit.
19. Të mos kenë sjellje që kanë ndikim negativ ose përbëjnë shqetësim për anëtarët e komunitetit përreth kampusit të UHZ-së;
20. Të distancohet nga çdo akt diskriminimi (sjellje fizike ose verbale) të bazuar në gjini, orientimin seksual, racë, fe ose besime fetare, ngjyrë, rajon, gjuhë, gjendjen martesore ose familjare, paaftësi fizike ose mendore të një individi.
21. Ndalohet regjistrimi video/audio, nxjerrja e fotografive ose transmetimi i audio/videove duke shkelur kështu privatësinë e individëve, pa dijeninë dhe shprehjen e pëlqimit paraprak.

Lista e veprimeve që janë të ndaluara të lartpërmendura nuk është shteruese, dhe shkeljet që nuk përmenden këtu mund të saksionohen nga UHZ duke marrë parasysh me kujdes natyrën e veprës apo keqpërdorimit.

Neni 4

Raportimi i shkeljes etike të pretenduar

1. Procedura e përgjegjësisë disiplinore fillon me rastin e raportimit të shkeljes së rregullave dhe parimeve etike të parapara me këtë kod.
2. Në kuadër të kësaj procedure, çdo student, personel i universitetit apo palë e përfshirë, i cili pretendon se ndaj tij, ndaj universitetit apo kulturës akademike janë shkelur të drejtat që janë sanksionuar me këtë kod, ka të drejtë dhe inkurajohet ta paraqesë shkeljen te komisioni disiplinor në nivel fakulteti, si organ i shkallës së parë.
3. Kur një palë raportuese raporton një shkelje, ai/ajo do të mbahet i informuar për afatet kohore që lidhen me hetimin dhe çdo proces disiplinor dhe do të njoftohet me përfundimin e procesit.

4. Njoftimi do të jetë specifik për secilin rast dhe do të përcaktohet duke marrë parasysh të drejtat e privatësisë për të gjitha palët dhe parimet e drejtësisë.
5. Dëshmitë e dëshmitarëve do të merren parasysh përmes deklaratave me shkrim, deklaratave në formë elektronike.
6. Universiteti do të mundësojë edhe raportimin anonim në mënyrë elektronike.
7. Universiteti nuk do të tolerojë raportime joserioze, shqetësuese ose keqdashëse.

Përveç sjelljes brenda kampusit, UHZ mund të ushtrojë gjithashtu juridiksion mbi sjelljen që ndodh jashtë kampusit (duke përfshirë çdo ngjarje ku studenti përfaqëson UHZ-në) ose nëpërmjet postimeve në medie sociale të cilat përbëjnë shkelje.

Neni 5

Procedura dhe afatet kohore për iniciimin e procedurës disiplinore

1. Shkelja e pretenduar mund të raportohet nga personeli akademik, administrativ, palët e treta apo studentët.
2. Nëse konstatohet se për rastin e paraqitur ka fakte të mjaftueshme për iniciimin e procedurës disiplinore, sekretari i fakultetit e njofton komisionin disiplinor që brenda (5) pesë ditëve të punës, pas paraqitjes së shkeljes së dyshuar, duhet të iniciojë procedurë disiplinore.
3. Procedura duhet të përfundojë brenda pesë (5), respektivisht 15 ditëve të punës, duke ndërmarrë hapat si në vijim:
 - a) njofton me shkrim personin/ studentin e dyshuar për shkelje se ndaj tij është iniciuar procedurë disiplinore;
 - b) të dyshuarit për shkelje etike i jepet e drejta për tu deklaruar;
 - c) kontakton me personin, i cili ka paraqitur shkeljen e dyshuar, duke e njoftuar me iniciimin e rastit dhe duke i dhënë mundësinë e deklaramit të tij;
 - d) kontakton dhe merr dëshmi me shkrim nga çdonjëri që mund të ofrojë dëshmi në lidhje me rastin;
 - e) komisioni disiplinor duhet të vendosë brenda 30 ditëve, prej ditës kur rasti i është paraqitur;
 - f) për shkak të kompleksitetit të çështjes etike, komisioni disiplinor në shkallë të parë mund të shtyjë afatin për përfundimin e procedurës disiplinore, por jo më gjatë se 30 ditë nga dita e përfundimit të afatit fillestar.
4. Me rastin e fillimit të procedurës disiplinore, komisioni obligohet të trajtojë rastin me kompetencë, besueshmëri, paanshmëri dhe në përputhje të plotë me parimet themelore të drejtësisë.
5. Kur shkeljet disiplinore përfshijnë ose mund të përfshijnë shkelje me nevojë për procedime penale, sekretari i fakultetit, në koordinimin me dekanin, e përcjell rastin tek organet kompetente rastin, ndërsa komisioni disiplinor nuk duhet ti pezullojë procedurat e brendshme për trajtimin e rastit disiplinor.

Neni 6
Shqiptimi dhe përshtatshmëria e masës disiplinore

1. Masat disiplinore shqiptohen në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara.
2. Me rastin e caktimit të një mase disiplinore duhet të merren parasysh çdo rrethanë lehtësuese apo rënduese, si:
 - a) rrezikshmëria e shkeljes;
 - b) shkalla e përgjegjësisë së studentit;
 - c) rrethanat në të cilat është kryer shkelja;
 - d) pasojat e shkaktuara;
 - e) sjellja e studentit para kryerjes së shkeljes dhe gjatë procedurës disiplinore;
 - f) nëse studenti i dyshuar për shkelje ka marrë masë disiplinore të mëparshme, e cila nuk është shlyer nga evidencat e dosjes së studentit.

Neni 7
Procedura e shqyrtimit dhe marrja e masave

Shqyrtimi i shkeljes së pretenduar etike dhe shqiptimi i masave behët nga këshilli i njësie njësisë akademike në përputhje me dispozitat e rregullore në fuqi për procedurën dhe masat disiplinore për studentët e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kodi i Etikës për Studentët e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë hynë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UHZ - së

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë

Prof.Ass. Dr. Majlinda Belegu



